



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorozuar Primjenof/Prodato Received/Delivery	26-08-2022	2	viti god year
Organ/Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5001/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.586/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Shyti -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.586/2022 të datës 30.06.2022, të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson me adresë:

kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.08.2022, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.586/2022 e datës 30.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi Nr.Ref:26/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës i datës 20.06.2022.

III. Obligohet Drejtorit i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, ndërsa ankueses t’ia kthej detyrat dhe përgjegjësitë e sigurisë së aviacionit të cilat i mban sipas Akt emërimit AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja fillimisht është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 ku ka mbajtur pozitën si “Menaxhere e Auditimit të brendshëm dhe kontrollit



të cilësisë” në Zyrën e Auditimit të brendshëm dhe kontroll të cilësisë në këtë institucion. Po ashtu e njëjta me datën 01.08.2018 bazuar në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemin e vendeve të punës është emëruar në pozitën “Drejtor i departamentit për siguri dhe cilësi” në Departamentin për siguri dhe cilësi sipas së cilës mban edhe Akt emërimin AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018.

Me datën 19.12.2018, përmes shkresës me numër AACK/ADM/BNJ-28, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, kishte lëshuar autorizimin lidhur me marrjen e detyrës së Inspektorit të akredituar të operimeve për helikopter nga ana e ankuesit.

Me datën 20.06.2022, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.Ref:26/2022, sipas të cilit përgjegjësitë e sigurisë së aviacionit, të dhëna Departamentit për cilësi dhe siguri (zyrës për auditim të brendshëm dhe kontroll të cilësisë) përmes pikës 1 të urdhrin nr 01/UA/2015 të datës 02.10.2015, kalojnë në kuadër të Zyrës së drejtorit të përgjithshëm, si dhe është caktuar nëpunësi B.Xh. (në pozitën si inspektor i vlefshmërisë ajrore) si udhëheqës për ushtrimin e përgjegjësiave të sigurisë së aviacionit.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin Nr.Ref:26/2022 të datës 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, me datën 30.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3835/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i njëjti përmban shkelje ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 05.07.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 3908/2022 për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa me datën 14.07.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Me datën 10.08.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.73/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3835/2022 të datës 30.06.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimin e ankueses të datës 01.08.2018; së bashku me formularin PDP lidhur me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin Nr.Ref:26/2022 të datës 20.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil; E-mailat zyrtar të datës 10.05.2022, 13.05.2022 dhe 16.05.2022; E-mailat zyrtar të datës 29.03.2022, 18.03.2022, 28.02.2022, 25.02.2022, 15.02.2022, 14.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.07.2022 nga Autoriteti i Aviacionit Civil së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailat zyrtar të datës 20.06.2022 dhe 21.06.2022; Akt emërimin e datës 01.01.2012 për nëpunësin B.XH; Vendimin me numër Nr.ref:1/2011 të datës 24.01.2011 nga Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së; Vendimin me numër Nr.ref 24/2011 të datës 17.08.2011 nga Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së; Urdhrin me numër Nr.01/UA/2015 të datës 02.10.2015 nga Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së; Përgjigjen në prova shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 01.08.2022 nga Autoriteti i Aviacionit Civil; Kërkesën për prova shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 01.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 01.04.2022, 13.06.2022, 06.06.2022, 12.05.2022; Vazhdimin e kartelës kredenciale të ankueses me numër AACK/ADM/BNJ/06 të datës 20.01.2020; Formularin e vlerësimit për inspektor me numër AACK/DSC-FRM 07 të datës 15.01.2020; Kartelën e kredencialeve të ankueses me numër CAA-03.2007 të datës 30.05.2022; Kartelën e kredencialeve të inspektorit të nëpunësit B.XH me

numër CAA-05/2008 të datës 30.05.2022'; Vazhdimi i kartelës së kredencialeve të inspektorit për B.XH me numër AACK/ADM/BNJ/12 të datës 20.01.2020; Formularin e vlerësimit për inspektor për B.XH me numër AACK/DSC-FRM 07 të datës 15.01.2020; E-mailat zyrtar të datës 22.06.2022, 21.06.2022, 11.02.2022, 07.02.2022; 19.04.2022; Vendimin me numër Nr.ref:16/2022 të datës 19.04.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së; Vendimin me numër VK.nr.73/2022 të datës 10.08.2022 të këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses **është e bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses në ankesë, ka analizuar Vendimin Nr.Ref:26/2022 të datës 20.06.2022 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil, sipas të cilit përgjegjësitë e sigurisë së aviacionit të dhëna Departamentit për cilësi dhe siguri (Zyrës për auditim të brendshëm dhe kontroll të cilësisë) sipas Urdhrit nr.01/UA/2015 të datës 02.10.2015, i ka kaluar në kuadër të Zyrës së Drejtorit të përgjithshëm dhe njëherit është caktuar nëpunësi Bajram Xhemali në pozitën aktuale si Inspektor i vlefshmërisë ajrore që të udhëheq me ushtrimin e përgjegjësive të sigurisë së aviacionit.

Ndërlidhur me këtë fakt, Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 17 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës të datës 17.01.2011, në, në të cilën përcaktohen përgjegjësitë e këtij departamenti e që ankuesja i mban me përshkrimin e detyrave të punës të cilat burojnë nga Akt emërimi AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018, për pozitën të cilën e mban si "Drejtor i Departamentit për Siguri dhe Cilësi", ka konstatuar se bazuar në nenin 33 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "*5. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse të administratës publike, me akt nënligjor, miraton: 5.1. klasat e zbatueshme për secilën kategori dhe emërtimet në çdo klasë; 5.2. grupet e administrimit të veçantë; 5.3. përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, duke përfshirë këtu kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori, klasë dhe grup; 5.4. rregullat e hollësishme, procedurat, standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e një pozite të caktuar në një klasë apo grup të caktuar, sipas këtij neni*" del se marrja e përgjegjësive të sigurisë së aviacionit civil nga Departamenti për Cilësi dhe Siguri e kalimi i tyre në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm nga ky i fundit, është bërë në kundërshtim me dispozitën e lart cekur, ngase për rastin konkret përderisa nuk kemi riorganizim të brendshëm përbrenda këtij institucioni, nuk mund të merren apo ndërrohen përgjegjësitë lidhur me pozitat aktuale të cilat janë të rregulluara sipas rregullores së brendshme të të njëjtit institucion.

Ndërlidhur me situatën juridike lidhur me ankesën e ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar po ashtu edhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 3 të Rregullores (QRK) nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në të cilën përcaktohet se: "*3. Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni*" dhe ka konstatuar se Vendimi Nr.Ref:26/2022 i datës 20.06.2022, i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, i cili është nxjerrë mbi bazën e arsytimit se ndryshimet e bëra janë të përkohshme dhe se janë të vlefshme deri në organizimin e ri të brendshëm, janë në kundërshtim me dispozitën e lartcekur, ngase për rastin konkret të ankueses, meqenëse e njëjta i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e saj të cilat i ka të përcaktuara me akt emërim dhe nuk kemi ndryshim të strukturës organizative apo detyrave të punës së ankueses me akt nën ligjor të hartuar dhe miratuar nga institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, atëherë edhe vendimi i lartcekur nuk është nxjerrë në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi dhe se për rastin e ankueses, Kolegji vlerëson se e njëjta duhet ti ushtrij përgjegjësitë dhe detyrat të cilat burojnë nga akt emërimi i saj deri në ndryshimin e strukturës së re organizative e cila nxirret nga institucioni përkatës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas nenit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ankuesja nuk hynë në kategorinë e përjashtimit nga fusha e zbatimit të këtij ligji, andaj Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Ref:26/2022 me datë 20.06.2022 përmes të cilit ankueses ia ka hequr përgjegjësit të cilat i ka të garantuara me aktin e emërimit AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018, është t'i ketë parasysh dispozitat e ligjit material për shërbimin civil të cilat nëpunësve civil ua garantojnë vazhdimësinë në detyrë siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”*, dhe mbi këtë bazë siç përcaktohet edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”*, Kolegji konstaton se Vendimi Nr.Ref:26/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm i datës 20.06.2022, vendim i cili atakuar përmes kësaj ankesa është i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar pasi që i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me çështjen e atakuar në ankesën e ankueses, ka analizuar dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se: *“1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit”* dhe ka konstatuar se në Vendimin Nr.Ref:26/2022 e datës 20.06.2022, i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, nuk përcaktohet saktë afati kohor se deri kur është në fuqi ky vendim si i tillë është lënë në diskrecion të pasqaruar lidhur me periudhën kohore për sa kohë do të prodhoj efekt juridik, andaj edhe i njëjti vendim si i tillë bie në kundërshtim me dispozitën e lartcekur dhe si i tillë është i kundërligjshëm siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”* dhe si i tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në rrethanat si më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencinë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për shfuqizimin e Vendimit Nr.Ref:26/2022 të datës 20.06.2022 lidhur me kalimin e përgjegjësive të sigurisë së aviacionit nga Departamenti për Cilësi dhe Siguri tek ai i Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe të njëjtat ti kthehen ankueses bazuar në përshkrimin e detyrave të punës dhe Akt emërimit AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018, për pozitën të cilën e mban si *“Drejtor i Departamentit për Siguri dhe Cilësi”* në kuadër të këtij institucioni, sipas afatit të theksuar si në piken III të këtij dispozitivi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura nga palët në procedurë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, me shumicë votash vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi, ndërsa mendimin mospajtuës i njërit prej anëtarëve të Kolegjit do t'i bashkëngjitet kësaj lëndë siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 1 të Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.586/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Përfaqësuesit ligjor të ankueses
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit civil dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.